Vlerësimi institucional me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset

Shkolla Profesionale “Stiliano Bandilli” Berat

Viti shkollor 2025 – 2026

Shtator 2026

Tabela e përmbajtjes

Hyrje 7
Metodologjia 7
Të dhëna për pjesëmarrësit 9
Rezultatet 10
Zhvillimi i vazhduar profesional 10
Kurrikula 10
Marrëdhënia me biznesit 11
Orientimi në karrierë 12
Projektet 12
Marketingu 13
Gjurmimi në nivel ofruesi 14

Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup 9
Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional 10
Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës 11
Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin 11
Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë 12
Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve 12
Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut 13
Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi 14

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" (S4J)

Aftësi për Punë (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Swisscontact, i cili synon të adresojë sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri. Që prej tetorit 2015, projekti "Aftësi për Punë" (S4J) mbështet qeverinë dhe aktorët e tjerë të interesit për të ndërtuar një sistem cilësor të AFP në Shqipëri, i frymëzuar nga modeli zviceran. Në fazën e tij të tretë (2024-2027), me theks të veçantë tek qëndrueshmëria, projekti është angazhuar në ndarjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe përvojave të përftuara në nivel sistemi, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat partnere.

Përmbledhje ekzekutive

Vlerësimi institucional 2025–2026 në Shkollën Profesionale “Stiliano Bandilli” Berat mbështetet në përgjigjet e 205 nxënësve, 17 mësuesve, 169 prindërve dhe 31 bizneseve. Ky është cikli i dytë i matjes në shkollë. Meqenëse në 2025 morën pjesë vetëm 4 biznese dhe shumë më pak nxënës e prindër (77 dhe 59), krahasimi me vitin e kaluar ka vlerë të kufizuar, sidomos për bizneset. Rezultatet e 2026 duhen lexuar kryesisht si pikë reference për vitet në vijim.

Pikat e forta

- Mësuesit e vlerësojnë shumë pozitivisht ZHVP-në: 94.1% e shohin në përputhje me nevojat e tyre, 94.1% raportojnë përmirësim të aftësive dhe 100% deklarojnë se i zbatojnë në mësimdhënie metodat e reja.
- Lidhja me tregun e punës perceptohet e fortë nga të gjitha palët: 100% e mësuesve e kanë të lehtë zbërthimin e kurrikulës sipas nevojave rajonale, 92.1% e nxënësve e shohin programin të përshtatur me tregun dhe 100% e bizneseve janë të kënaqura me përgatitjen e nxënësve.
- Praktika profesionale në biznes është e përhapur (88.9% e nxënësve), me kënaqësi të mirë për realizimin e saj sipas planit (81.0%).
- Orientimi në karrierë arrin 92.7% të nxënësve, ndërsa perceptimi i prindërve u përmirësua (kënaqësia 58.6% → 74.7%; ndikimi në vendimmarrjen e fëmijës 72.7% → 81.9%).

Fushat që kërkojnë vëmendje

- Kënaqësia e nxënësve me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor ra me 11 p.p. (86.0% → 75.0%).
- Cilësia e materialeve të marketingut vlerësohet më ulët se vitin e kaluar, si nga mësuesit (86.4% → 76.5%), ashtu edhe nga nxënësit (79.2% → 63.5%).
- Përfshirja e mësuesve në hartimin e projekteve zhvillimore ra në 41.2% (nga 65.2%).
- Mbështetja nga koordinatori i kurrikulës (82.4%) është treguesi më i ulët i mësuesve në 2026, ndërsa mësuesit i përdorin të dhënat e gjurmimit për procesin mësimor (70.6%) më pak se sa i përdor shkolla për planin vjetor (100%). Me 17 mësues, secili përfaqëson rreth 6 p.p.

Lidhjet ndërmjet funksioneve

- Mësuesit raportojnë zbatim të plotë të metodave të reja nga trajnimet (100%), ndërsa nxënësit janë më të rezervuar për metodat e përdorura (76.3%) dhe për ndërveprimin në klasë (75.0%). Ky dallim ndërmjet perceptimit të mësuesve dhe përvojës së nxënësve ia vlen të shqyrtohet gjatë hartimit të planit të ZHVP-së.
- Të dhënat e gjurmimit përdoren më shumë për planifikimin institucional se për përmirësimin e mësimdhënies; përkthimi i tyre në klasë është hapi i radhës.

Mbi bazën e këtyre gjetjeve, raporti përfundon me pesë rekomandime për forcimin institucional (shih seksionin “Rekomandime për forcimin institucional”).

Shënim: Ndryshimet ndërmjet viteve shprehen në pikë përqindjeje (p.p.). Lidhjet ndërmjet funksioneve paraqiten si modele të vëzhguara në të dhëna, jo si marrëdhënie shkak-pasojë.

Hyrje

Ky raport paraqet gjetjet nga procesi i **Vlerësimit Institucional** të zhvilluar në Shkollën **"Stiliano Bandilli"** për vitin shkollor 2025-2026. Procesi, me synim vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të aftësimit profesional, përfshiu nxënës, mësues, prindër dhe biznese partnere, të cilët u anketuan gjatë periudhës maj-qershor 2026.

Procesi u koordinua nga Njësia e Zhvillimit (NjZH) në shkollë, e cila luan një rol kyç në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve. Përshkrimi i gjetjeve në raport është i organizuar sipas treguesve për secilin funksion të NJZH-së.

Ky proces vlerësues mbështetet në përvojën e vitit shkollor 2023 - 2024, ku projekti 'Aftësi për Punë' (S4J), në bashkëpunim me gjashtë shkolla partnere[1], zhvilloi katër instrumente vlerësimi (pyetësorë), të bazuar në një metodologji rigoroze dhe pjesëmarrëse. Pas pilotimit në gjashtë shkolla, instrumentet u rishikuan për të garantuar vlefshmëri, qëndrueshmëri dhe respektim të standardeve etike[2].

Metodologjia

Në kuadër të mbledhjes së informacionit që do të ushqejë analizën vjetore të performancës institucionale, në përfundim të çdo viti shkollor do të realizohet një proces vlerësimi institucional në nivel ofruesi duke përfshirë katër grupeve kryesore: nxënës, mësues, biznese dhe prindër. Ky proces synon të vlerësojë performancën institucionale, të identifikojë fushat për përmirësim dhe të informojë objektivat e planit vjetor të institucionit.

Për këtë qëllim, janë zhvilluar katër instrumente vlerësimi (pyetësor), si vijon:

Pyetësori për nxënësit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e nxënësve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në cilësinë e mësimdhënies, praktikën profesionale, orientimin në karrierë dhe performancën e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i programeve për të përgatitur më mirë nxënësit për tregun e punës.

Pyetësori për mësuesit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e mësuesve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional dhe mjedisit të të nxënit. Fokusohet në zhvillimin profesional, zbërthimin e kurrikulës, projektet zhvillimore dhe dhe performancën e institucionit. Qëllimi është identifikimi i fushave për përmirësim dhe përshtatja e praktikave me nevojat e stafit dhe nxënësve.

Pyetësori për bizneset synon të mbledh perceptimet e bizneseve për cilësinë e bashkëpunimit me institucionin dhe përvojën me nxënësit gjatë praktikës profesionale. Fokusohet në përgatitjen e nxënësve, përputhshmërinë e programeve të praktikës me nevojat e tregut të punës dhe mundësitë për përmirësim. Qëllimi është forcimi i bashkëpunimit dhe angazhimi cilësor i sektorit privat në proceset e aftësimit profesional.

---

[1] Hamdi Bushati, Kolin Gjoka, Kristo Isak, Shkolla Profesionale Elbasan, Shkolla Teknike Ekonomike Tirane, Tregtare.
[2] Për më shumë informacion, shih raportin Baseline i treguesve të cilësisë së Njësisë së Zhvillimit https://skillsforjobs.al/publications/baseline-i-treguesve-te-cilesise-se-njesise-se-zhvillimit/

Pyetësori për prindërit synon të mbledhë mendimet e prindërve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në komunikimin me shkollën, orientimin në karrierë të fëmijëve dhe imazhin e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i shërbimeve për të përmbushur pritshmëritë dhe nevojat e nxënësve dhe prindërve.

Të dhëna për pjesëmarrësit

Për vitin shkollor 2025-2026, në shkollën profesionale "Stiliano Bandilli" 205 nxënës morën pjesë në sondazh. Nga këta, 95.6% (N=196) ishin djem, 2.4% (N=5) ishin vajza dhe 2% (N=4) preferoj të mos përgjigjet. Të shpërndarë sipas klasave, 28.3% (N=58) e të anketuarve janë në klasën e dhjetë, 24.9% (N=51) në klasën e njëmbëdhjetë, 26.3% (N=54) në klasën e dymbëdhjetë, 18% (N=37) në klasën e trembëdhjetë dhe 2% (N=4) arsim profesional pas të mesëm.

Ndërkohë, 17 mësues morën pjesë në anketim. Nga këta mësues të përfshirë në anketim 29.4% (N=5) janë femra dhe 70.6% (N=12) janë meshkuj. Të ndarë sipas grup lëndëve që japin mësim 29.4% (N=5) japin lëndë të teorisë profesionale, 41.2% (N=7) japin njëkohësisht lëndë të teorisë profesionale dhe module të praktikës profesionale dhe 29.4% (N=5) japin module të praktikës profesionale

Në sondazh kanë marrë pjesë 31 biznese. Rezultatet tregojnë një nivel të lartë diversifikimi të formave të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve dhe shkollës. Pjesa më e madhe e bizneseve, 87.1% (N=27), angazhohen në më shumë se 5 modalitete bashkëpunimi, ndërsa 3.2% (N=1) raportojnë 3-4 modalitete dhe 9.7% (N=3) 1-2 modalitete. Kjo tregon se, në shumicën e rasteve, bashkëpunimi biznes–shkollë nuk kufizohet vetëm në një formë të vetme, por shtrihet në disa forma të ndryshme. Për sa i përket praktikës profesionale, rezulton se 88.9% (N=128) e nxënësve e zhvillojnë praktikën profesionale pranë një biznesi, ndërsa 11.1% (N=16) e nxënësve nuk kanë nisur ende praktikën profesionale.

Në shkollën Stiliano Bandilli kanë marrë pjesë në sondazh 169 prindër. Nga këta 33.1% (N=56) janë femra, 63.3% (N=107) janë meshkuj dhe vetëm 3.6% (N=6) nuk kanë preferuar të përgjigjen. Të shpërndarë sipas klasës që ndjek fëmija, 30.5% (N=51) kanë pohuar se fëmija e tyre ndjek klasën e dhjetë, 27.5% (N=46) klasën e njëmbëdhjetë, 26.9% (N=45) klasën e dymbëdhjetë, 13.8% (N=23) klasën e trembëdhjetë dhe 1.2% (N=2) ndjekin arsimin profesional pas të mesëm. 81.0% (N=47) e prindërve janë të kënaqur me cilësinë e komunikimit me shkollën, dhe 72.4% (N=42) kanë pohuar se e vlerësojne si shumë të mirë imazhin që ka institucioni në qytetin e tyre.

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup

Përfituesit	2025	2026
Nxënës	77	205
Mësues	23	17
Prindër	59	169
Biznese	4	31

Rezultatet

Seksionet më poshtë përmbledhin rezultatet e matjeve me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset. Ndërkohë, listën e plotë të gjetjeve për cdo pyetësor e gjeni në Shtojcën 1.

Zhvillimi i vazhduar profesional

Për sa i përket zhvillimit të vazhduar profesional, 94.1% e mësuesve kanë vlerësuar se aktivitetet e ZHVP-së janë në përputhje me nevojat e tyre, ndërsa po kaq, 94.1%, kanë pohuar se aftësitë e tyre janë përmirësuar si rezultat i trajnimeve dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e ZHVP-së. Krahasuar me vitin 2025, këta tregues kanë shënuar një rritje të ndjeshme, përkatësisht nga 69.6% dhe 77.3%. Gjithashtu, 100% e mësuesve janë shprehur të kënaqur me mbështetjen e marrë gjatë zbatimit të planit dhe raportojnë se i aplikojnë në mësimdhënie njohuritë, aftësitë, shprehitë dhe metodat e reja të mësuara gjatë trajnimeve dhe shkëmbimeve. Nga ana tjetër, nxënësit kanë dhënë vlerësime përgjithësisht pozitive: 86.3% janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies, 76.3% janë të kënaqur me metodat e përdorura gjatë procesit mësimor, ndërsa 75% janë të kënaqur me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor, ku kjo e fundit shënon rënie prej 11% nga viti i shkuar duke treguar nevojën për më shumë vëmendje ndaj këtij aspekti të procesit mësimor.

Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Mësuesit e kulturës profesionale – përfitues direkt	1. Aktivitetet e ZHVP janë në përputhje me nevojat e mësuesve.	69.6%	94.1%
	2. Aftësitë e mësuesve janë përmirësuar nga trajnimet/aktivitetet e parashikuara në planin e ZHVP.	77.3%	94.1%
	3. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë gjatë zbatimit të planit të ZHVP.	90.9%	100%
	4. Mësuesit aplikojnë në mësimdhënie njohuritë aftësitë, shprehitë dhe metodat e reja të mësimdhënies që kanë mësuar në trajnime dhe shkëmbime.	52.2%	100%
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies (si p.sh., puna në grup, puna me projekte, përdorimi i teknologjisë, ndërveprimi në klasë etj.).	81.8%	86.3%
	2. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies.	61.3%	76.3%
	3. Nxënësit janë të kënaqur me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor.	86.0%	75.0%

Kurrikula

100% e mësuesve kanë deklaruar se e kanë më të lehtë zbërthimin e kurrikulës në përputhje me nevojat rajonale të tregut të punës, ndërsa 82.4% janë shprehur të kënaqur me mbështetjen e marrë nga koordinatori i kurrikulës. Nga ana tjetër, 92.1% e nxënësve besojnë se programi mësimor është i përshtatur me tregun e punës, duke treguar një lidhje të fortë mes arsimit dhe kërkesave praktike. Po ashtu, bizneset kanë dhënë vlerësime shumë pozitive: 100% janë të kënaqura me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që kanë marrë nxënësit në shkollë, ndërsa 87.1% mendojnë se planet e praktikës profesionale janë në përshtatje me nevojat e tyre.

Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit e kanë më të lehtë zbërthimin e kurrikulës në përputhet me nevojat rajonale të tregut të punës.	91.3%	100%
	2. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë nga koordinatori i kurrikulës për zbatimin e mësimdhënies	78.3%	82.4%
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit mendojnë se programi mësimor është e përshtatur me tregun e punës.	95.7%	92.1%
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset janë të kënaqur me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që kanë marrë nxënësit në shkollë.	100%	100%
	2. Bizneset mendojnë se planet e praktikës profesionale janë në përshtatje me nevojat e tyre.	75.0%	87.1%

Marrëdhënia me biznesit

88.9% e nxënësve kanë marrë pjesë në praktikë profesionale në biznese, ndërsa 78.1% janë shprehur të kënaqur me mundësitë që ofron shkolla për praktikë profesionale dhe 81% me realizimin e praktikës sipas planit. Nga ana tjetër, treguesit e bashkëpunimit me bizneset paraqiten përgjithësisht pozitivë, megjithëse në disa raste kanë shënuar rënie të lehtë krahasuar me vitin 2025. 87.1% e tyre raportojnë bashkëpunim në forma të ndryshme me shkollën, ndërsa 88.2% janë të kënaqura me bashkëpunimin. Po ashtu, 67.7% deklarojnë se bashkëpunojnë ngushtë me shkollën, ndërsa 100% janë të kënaqura me cilësinë e përgatitjes së nxënësve. Gjithashtu, 93.3% mendojnë se shkolla përmbush nevojat e biznesit për aftësi cilësore pune, ndërsa 93.3% njohin programin mësimor dhe 93.5% modulet profesionale që ofron shkolla.

Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Nxënësit – përfitues direkt	1. % e nxënësve që kanë bërë praktikë profesionale në biznes.	75.3%	88.9%
	2. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me mundësitë që ofron shkolla për praktikë profesionale në biznes.	70.7%	78.1%
	3. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me realizimin e praktikës profesionale në biznes sipas planit të praktikës.	70.7%	81%
Bizneset – përfitues direkt	1. Bizneset bashkëpunojnë në forma të ndryshme me shkollën.	100%	87.1%
	2. Bizneset janë të kënaqura për bashkëpunimin me shkollën.	100%	88.2%
	3. Bizneset bashkëpunojnë ngushtë me shkollën.	75.0%	67.7%
	4. Bizneset janë të kënaqur me cilësinë e përgatitjes së nxënësve nga shkolla.	100%	100%
	5. Bizneset mendojnë se shkolla përmbush nevojat e biznesit për aftësi cilësore pune.	100%	93.3%
	6. Biznesi njeh programin mësimor që ofron shkolla.	100%	93.3%

	7. Biznesi njeh shumë mirë modulet profesionale qe ofron shkolla.	100%	93.5%

Orientimi në karrierë

92.7% e nxënësve kanë marrë shërbime të ndryshme për orientimin në karrierë, ndërsa 80.8% janë shprehur të kënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar në sesionet e orientimit. Gjithashtu, 74.8% ndihen të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që studiojnë. Nga ana tjetër, 74.7% e prindërve janë shprehur të kënaqur me shërbimin që shkolla ofron për orientimin në karrierë të fëmijës, ndërsa 81.9% besojnë se orientimi në karrierë i ka ndihmuar fëmijët të marrin vendimet e duhura për karrierën e tyre.

Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit kanë marrë shërbime të ndryshme për orientimin në karrierë.	87.1%	92.7%
	2. Nxënësit janë të kënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar në sesionet e orientimit në karrierë.	85.7%	80.8%
	3. Nxënësit janë të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që po studiojnë.	63.8%	74.8%
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit janë të kënaqur me shërbimin për orientim në karrierë që i jep shkolla fëmijës.	58.6%	74.7%
	2. Prindërit besojnë se orientimi në karrierë e ka ndihmuar fëmijën për të marrë vendimet e duhura për karrierën.	72.7%	81.9%

Projektet

100% e mësuesve kanë pohuar se i njohin projektet zhvillimore të shkollës, ndërsa 88.2% mendojnë se ato përmirësojnë cilësinë e arsimit. Sa i përket përfshirjes, 41.2% e mësuesve marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e tyre. Nga ana tjetër, 79.8% e nxënësve janë në dijeni të projekteve zhvillimore të shkollës dhe 75.8% janë të përfshirë në to. Gjithashtu, 73.7% e nxënësve shprehen të kënaqur me përfshirjen në aktivitetet e projekteve të zhvilluara nga shkolla, ndërsa 85.5% janë të kënaqur me rezultatet e projekteve të zbatuara.

Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit i njohin projektet zhvillimore të shkollës	90.9%	100%
	2. Mësuesit mendojnë se projektet zhvillimore të shkollës përmirësojnë cilësinë e arsimit	72.7%	88.2%
	3. Mësuesit janë të përfshirë në shkrimin e projekteve zhvillimore si pjesë e grupeve të punës	65.2%	41.2%
	4. Mësuesit janë të përfshirë zbatimin e projekteve zhvillimore.	52.2%	

Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit janë të dijeni të projekteve zhvillimore në shkollë.	79.1%	79.8%
	2. Nxënësit janë të përfshirë në projekte zhvillimore	67.3%	75.8%
	3. Nxënësit janë të kënaqur me përfshirjen në aktivitete të projekteve të zhvilluara nga shkolla.	74.2%	73.7%
	4. Nxënësit janë të kënaqur me rezultatet e projekteve të zbatuara nga shkolla.	74.2%	85.5%

Marketingu

Për sa i përket marketingut, vlerësimet e vitit 2026 paraqiten përgjithësisht më pozitive krahasuar me vitin e mëparshëm. 94.1% e mësuesve shprehen të kënaqur me aktivitetet e planit të marketingut dhe po 94.1% vlerësojnë pozitivisht imazhin e shkollës, ndërsa 58.8% ndihen të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitetet e marketingut. Në të njëjtën linjë paraqiten edhe vlerësimet e nxënësve, ku 81.5% janë të kënaqur me aktivitetet e marketingut dhe 82.3% me imazhin e shkollës. Megjithatë, një aspekt që kërkon më shumë vëmendje është cilësia e materialeve informuese, e cila është vlerësuar më ulët se në vitin e kaluar, si nga mësuesit (76.5%), ashtu edhe nga nxënësit (63.5%). Bizneset vazhdojnë ta vlerësojnë pozitivisht reputacionin dhe imazhin e shkollës, me 100% të vlerësimeve pozitive, ndërsa perceptimi i prindërve mbetet pothuajse në të njëjtin nivel, me 72.1%. Në tërësi, rezultatet tregojnë një perceptim më pozitiv të aktiviteteve të marketingut dhe imazhit të shkollës, por evidentojnë nevojën për përmirësimin e cilësisë së materialeve informuese.

Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Mësuesit – përfitues indirekt	1. Mësuesit janë të kënaqur me aktivitetet e planit të marketingut të shkollës.	81.8%	94.1%
	2. Mësuesit mendojnë se materialet informuese për marketingun janë cilësore	86.4%	76.5%
	3. Mësuesit janë të kënaqur me imazhi që ka shkollë	87.0%	94.1%
	4. Mësuesit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut të shkollës.	45.5%	58.8%
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me aktivitetet e marketingut të shkollës	70.8%	81.5%
	2. Nxënësit mendojnë se informacioni i dhënë në materialet e marketingut është cilësor.	79.2%	63.5%
	3. Nxënësit janë të kënaqur me imazhit të shkollës.	73.0%	82.3%

	4. Nxënësit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut.	45.6%	50.5%
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset e vlerësojnë shkollën si institucion me reputacion/ imazh të mirë.	100%	100%
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit e nxënësve të shkollës dhe nxënësve të klasave të 8-9 vlerësojnë shkollën si institucion me imazh të mirë.	72.4%	72.1%

Gjurmimi në nivel ofruesi

70.6% e drejtuesve dhe mësuesve kanë deklaruar se përdorin të dhënat e gjurmimit për të përmirësuar procesin mësimor dhe aktivitetet e lidhura me të, ndërsa 100% kanë pohuar se shkolla i shfrytëzon këto të dhëna për përmirësimin e aktivitetit vjetor. Këto rezultate tregojnë një nivel të mirë të përdorimit të informacionit për planifikim strategjik, megjithëse përdorimi i tij nga mësuesit në procesin mësimor mbetet më i kufizuar.

Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Drejtuesi dhe Mësuesit – përfitues direkt	1. Drejtuesit dhe mësuesit përdorin të dhënat e gjurmimit për të përmirësuar procesin mësimor dhe aktivitetet e lidhura me të.	60.9%	70.6%
	2. Shkolla i përdor të dhënat e gjurmimit për përmirësimin e aktivitetit vjetor	91.3%	100%

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme bazohen në gjetjet e ciklit 2025–2026 dhe janë menduar si pika hyrëse për planin vjetor të shkollës. Duke qenë se krahasimi me vitin 2025 ka bazë të kufizuar, ato mbështeten kryesisht në rezultatet e vitit 2026.

1. Nga trajnimi te ora e mësimit

Plani i ZHVP-së të përfshijë vëzhgime të ndërsjella mes mësuesve dhe një vlerësim të shkurtër nga nxënësit, për të parë nëse metodat e reja po ndihen në klasë.

> **Gjetja:** 100% e mësuesve deklarojnë se i zbatojnë në mësimdhënie metodat e reja nga trajnimet, ndërsa 76.3% e nxënësve janë të kënaqur me metodat e përdorura dhe kënaqësia me shpeshtësinë e ndërveprimit ra nga 86.0% në 75.0%.

2. Informacion promovues më i qartë

Përmbajtja dhe kanalet e materialeve promovuese të rishikohen me nxënësit përpara fushatës së ardhshme të regjistrimeve.

> **Gjetja:** Vlerësimi i cilësisë së materialeve informuese ra nga 86.4% në 76.5% te mësuesit dhe nga 79.2% në 63.5% te nxënësit.

3. Më shumë mësues në hartimin e projekteve

Grupet e punës për projektet zhvillimore të hapen për më shumë mësues, me rotacion të anëtarësisë nga një projekt në tjetrin.

> **Gjetja:** Përfshirja e mësuesve në hartimin e projekteve ra nga 65.2% në 41.2%, ndërkohë që 100% e tyre i njohin projektet zhvillimore të shkollës.

4. Mbështetje e planifikuar nga koordinatori i kurrikulës

Të caktohet një kalendar takimesh mbështetëse në çdo tremujor, me vëmendje të veçantë për mësuesit më të rinj në institucion.

> **Gjetja:** Kënaqësia me mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës (82.4%) është treguesi më i ulët i mësuesve në vitin 2026. Me 17 mësues, çdo mësues përfaqëson rreth 6 p.p.

5. Gjurmimi në mësimdhënie dhe një bazë e qëndrueshme krahasimi

Gjetjet e gjurmimit të ndahen me ekipet mësimore, dhe në ciklin e ardhshëm të synohet i njëjti nivel pjesëmarrjeje si në 2026, që viti aktual të shërbejë si bazë e besueshme krahasimi.

> **Gjetja:** Shkolla i përdor të dhënat e gjurmimit për planin vjetor në masën 100%, por vetëm 70.6% e mësuesve i përdorin ato në procesin mësimor. Në 2025 morën pjesë vetëm 4 biznese, 77 nxënës dhe 59 prindër.

Shtojca

Gjetjet nga pyetësorët, viti shkollor 2025-2026



Shkolla Stiliano Bandilli_Indeksi.xlsx